



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.162

27 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 174 datë 29.10.2009	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 24.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për dërgimin e një toge mjekësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Kabul, Afganistan”	7209
Ligj nr.10 175 datë 29.10.2009	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”	7209
Ligj nr. 10 176 datë 29.10.2009	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, të ndryshuar” ...	7210
Ligj nr.10 177 datë 29.10.2009	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të zhvillimit””	7210
Ligj nr.10 178 datë 29.10.2009	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.9880,datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik””	7211
Vendim i KM nr.976, datë 8.10.2009	Për hapjen e programeve të studimit të ciklit të parë, në “Administrim dhe politikë sociale”, në Fakultetin e Shkencave Sociale, e “Bioteknologji”, në Fakultetin e Shkencave Natyrore të universitetit të Tiranës, si dhe për përcaktimin e kuotave të pranimit e të tarifave të shkollimit për vitin akademik 2009-2010	7211

Vendim i KM nr.977, datë 8.10.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.856, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programit të studimit të ciklit të parë “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në Universitetin “Fan.S.Noli” të Korçës”	7212
Vendim i KM nr.978, datë 8.10.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.857, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen në qytetin e Peshkopisë të filialeve dhe programeve të studimit të Fakulteteve të Ekonomisë e të Administrimit, të Edukimit dhe të Shkollës së Lartë Profesionale të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, si dhe për miratimin e kuotave të pranimit të tarifës së shkollimit në këto programe studimi, në vitin akademik 2009-2010”, të ndryshuar	7213
Vendim i KM nr.1055, datë 29.7.2009	Për licencimin e shkollës së lartë private “Logos”	7214
Vendim i KM nr.1057, datë 30.9.2009	Për përcaktimin e kompetencave të Ministrit të Shtetit për reformat dhe marrëdhëniet me Kuvendin në fushën e komunikimeve elektronike	7215
Vendim i KM nr.1058, datë 21.10.2009	Për përcaktimin e kufirit minimal të regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH).....	7215
Vendim i KM nr.1062, datë 21.10.2009	Për lejimin e kalimit tranzit të katër autokolonave ushtarake sllovene, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	7216
Vendim i KM nr.1067, datë 21.10.2009	Për dhënien e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollës 9-vjeçare, të ciklit të lartë “Hafiz Abdulla Zëmbaku”, që në programin mësimor do të zhvillojë edhe lëndë fetare	7217
Vendim i KM nr.1068, datë 21.10.2009	Për hapjen e programeve të studimeve “Master i niveli të dytë”, në kimi dhe kimi industriale e mjedisore, në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës	7217
Vendim i KM nr.1069, datë 21.10.2009	Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja dhe në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, si dhe për përcaktimin e kuotave të pranimit dhe të tarifës së shkollimit për këto programe studimi	7218
Vendim i KM nr.1070, datë 21.10.2009	Për përcaktimin e kuotave të pranimit dhe të tarifave të shkollimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë”, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2009-2010, dhe për një ndryshim në vendimin nr.829, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve dhe miratimin e kuotave dhe të tarifave për këto programe”	7219
Vendim i KM nr.1071, datë 21.10.2009	Për lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të kryejë procedurën e prokurimit, me objekt “Blerjen dhe instalimin e 26 kabinave të kontrollit”	7222

Vendim i KM nr.1075, datë 21.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Farkë të qarkut të Tiranës	7223
Vendim i KM nr.1076, datë 21.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës	7224
Vendim i KM nr.1079, datë 21.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Buz të qarkut të Gjirokastrës	7225
Vendim i GJL nr.2/1, datë 2.10.2009	Ndreqja e vendimit nr.2, datë 6.2.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	7227
Vendim i ERE nr.78, datë 23.10.2009	Për licencimin e shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k.....	7229
Vendim i ERE nr.79, datë 23.10.2009	Për miratimin e modifikimit të licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë Balkan Green Energy sh.p.k. me seri PV03K, nr.3, lëshuar me vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 19.12.2003	7230
Kërkesë e MPPTT nr.6191, datë 7.10.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi “Bajram Curri” deri në rrugën “Ali Demi”	7232

LIGJ
Nr.10 174, datë 29.10.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.4, DATË 24.9.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DËRGIMIN E NJË TOGE MJEKËSORE TË
FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KABUL,
AFGANISTAN”**

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 24.9.2009, i Këshillit të Ministrave “Për dërgimin e një toge mjekësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Kabul, Afganistan”.

**Shpallur me dekretin nr.6333, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 175, datë 29.10.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË 30.9.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9948, DATË
7.7.2008 “PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE
TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 30.9.2009, i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.6334, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr. 10 176, datë 29.10.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 6, DATË 30.9.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8669, DATË
26.10.2000 “PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM TË POPULLSISË DHE TË
BANESAVE”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 30.9.2009, i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave”, të ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.6335, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 177, datë 29.10.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 7, DATË 30.9.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.10 130, DATË
11.5.2009 “PËR FONDIN SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.7, datë 30.9.2009, i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.10 130, datë 11.5.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”.

**Shpallur me dekretin nr.6336, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 178, datë 29.10.2009

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 8, DATË 30.9.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9880, DATË
25.2.2008 “PËR NËNSHKRIMIN ELEKTRONIK””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.8, datë 30.9.2009, i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në ligjin nr.9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik””.

**Shpallur me dekretin nr.6337, datë 17.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.976, datë 8.10.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, NË
“ADMINISTRIM DHE POLITIKË SOCIALE”, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE
SOCIALE, E “BIOTEKNOLOGJI”, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE NATYRORE TË
UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË
PRANIMIT E TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2009-2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.1, 33, pika 2,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen në Universitetin e Tiranës, të programeve të studimit, të ciklit të parë, sipas fakulteteve:

- a) Në Fakultetin e Shkencave Sociale të programit “Administrim dhe politikë sociale”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, (DNP), në administrim dhe politikë sociale;
- b) Në Fakultetin e Shkencave Natyrore të programit “Bioteknologji”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë, (DNP), në bioteknologji.

2. Këto programe studimi realizohen me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

3. Programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.

4. Numri i kuotave të pranimit për vitin akademik 2009-2010 të jetë, si më poshtë vijon:

- a) 50 kuota, për programin “Administrim dhe politikë sociale”;
- b) 80 kuota për programin e studimit “Bioteknologji”.

5. Tarifa vjetore e shkollimit, për këto programe studimi me kohë të plotë, të jetë, si më poshtë vijon:

- a) Për programin “Administrim dhe politikë sociale”, 30 000 (tridhjetë mijë) lekë;
- b) Për programin “Bioteknologji”, 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.
6. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën e studimit në njërin nga këto programe, në vitin akademik 2009-2010, dhe që vijnë nga këto shtresa sociale, si të verbër/shurdhër, invalidë paraplegjikë e tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijë të policëve të rënë a të plagosur për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit.
7. Kuota e pranimeve për të verbërit ndahet për kandidatët me këtë status nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, pasi të merret mendimi i Shoqatës Kombëtare të të Verbërve.
8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.
9. Në secilin nga këto programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, në vitin akademik 2009-2010, 5 (pesë) studentët e vitit të parë, me notën mesatare më të lartë të shkollës së mesme, të provimeve të “Maturës shtetërore”, të përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit. Këtë përjashtim, në asnjë rast, nuk e përfitojnë studentët me notë mesatare të shkollës së mesme më të ulët se nota 8 (tetë).
10. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet në njërin nga këto programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve, kur, në marrëveshjet zyrtare shtetërore, janë vendosur mënyra të tjera të përcaktimit të tarifave të shkollimit.
11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për Universitetin e Tiranës.
12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.977, datë 8.10.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.856, DATË 5.8.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “GJUHË-LETËRSI SHQIPE DHE FRËNGE”, NË UNIVERSITETIN “FAN.S.NOLI” TË KORÇËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.856, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1.Hapjen në universitetin “Fan. S. Noli” të Korçës, në fakultetin e mësuesisë, të programit të studimit “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP), në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge”.”.
2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:
“3/1. Kuota e pranimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 50 (pesëdhjetë).

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:
“4/1. Tarifa e shkollimit në programin e studimit të ciklit të parë, me kohë të plotë, në “Gjuhë-letërsi shqipe dhe frënge” është 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë.”.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.978, datë 8.10.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.857, DATË 5.8.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN NË QYTETIN E PESHKOPIË TË FILIALEVE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË FAKULTETEVE TË EKONOMISË E TË ADMINISTRIMIT, TË EDUKIMIT DHE TË SHKOLLËS SË LARTË PROFESIONALE TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS, SI DHE PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË KËTO PROGRAME STUDIMI, NË VITIN AKADEMIK 2009-2010”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pikat 1.11 e 2, shkronja “b”, 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 8 e vendimit nr. 857, datë 5.8.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

“8. Numri i kuotave të pranimeve, në këto programe studimi të ciklit të parë, me kohë të plotë, për vitin akademik 2009-2010, është përcaktuar në tabelën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA E KUOTAVE TË PRANIMIT TË PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË ME KOHË TË PLOTË TË UNIVERSITETIT “ALEKSANDËR MOISIU”, Durrës (FILIALI PESHKOPI)

Nr.	PROGRAMET E STUDIMIT	KUOTAT
	FAKULTETI I EKONOMISË DHE I ADMINISTRIMIT	
1	Shkenca të Administrimit (profil Financë-Kontabilitet)	30
2	Shkenca të Administrimit (profil Financë- Bankë)	30
3	Shkenca të Administrimit (profil Menaxhim-Marketing)	30
4	Shkenca të Administrimit (profil Administrim-Biznesi)	30
	FAKULTETI I EDUKIMIT	
1	Informatikë-Anglisht	30
2	Gjuhë-Letërsi-Anglisht	30
3	Matematikë-Fizikë	30
4	Matematikë-Informatikë	30
5	Biologji-Kimi	30
6	Psikologji-Sociologji	30
7	Procese formimi	30
	SHKOLLA E LARTË PROFESIONALE	
1	Drejtësi (Asistent ligjor)	30
2	Infermieri e përgjithshme (3-vjeçare)	30
3	Informatikë (Specialist Rrjetash Kompjuterike)	30
	Gjithsej	420

**VENDIM
Nr.1055, datë 29.7.2009**

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “LOGOS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2,43,44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Logos”, e cila do të ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Logos” do të organizohet në dy fakultete:

a) Fakultetin e shkencave të aplikuara, me programin e studimit të ciklit të parë “Informatikë e zbatuar”, në formën e studimeve, me kohë të plotë.

b) Fakultetin ekonomik, me programin e studimit të ciklit të parë “Menaxhim turizmi”, në formën e studimeve, me kohë të plotë.

3. Shkolla e lartë private “Logos” do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, me kohëzgjatje 3 (tri) vite akademike, me plotësimin, së paku, të 180 krediteve. Në përfundim të këtyre programeve të studimit lëshohet diplomë e niveli të parë (DNP), në:

a) “Informatikë e zbatuar”;

b) “Menaxhim turizmi”.

4. Ngarkohet shkolla e lartë private “Logos” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplineve kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Shkolla e lartë private “Logos” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë private “Logos” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1057, datë 30.9.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KOMPETENCAVE TË MINISTRIT TË SHETIT PËR
REFORMAT DHE MARRËDHËNIET ME KUVENDIN NË FUSHËN
E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ushtrimin nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin të kompetencave të ministrit përgjegjës në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1058, datë 21.10.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT MINIMAL TË REGJISTRIMIT PËR TATIMIN MBI
VLERËN E SHTUAR (TVSH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5 të nenit 3 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kufiri minimal i regjistrimit për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) të jetë 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për vit kalendarik.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1062, datë 21.10.2009

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË KATËR AUTOKOLONAVE USHTARAKE
SLOVENE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 20 tetor 2009, të 2 (dy) autokolonave ushtarake slovene, të përbëra, si më poshtë vijon:
 - Autokolona e parë nga 2 (dy) automjete dhe 5 (pesë) trupa.
 - Autokolona e dytë nga 3 (tri) automjete dhe 7 (shtatë) trupa.
 2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në datën 28 tetor 2009, të 2 (dy) autokolonave ushtarake slovene, të përbëra, si më poshtë vijon:
 - Autokolona e parë nga 4 (katër) automjete dhe 15 (pesëmbëdhjetë) trupa.
 - Autokolona e dytë nga 2 (dy) automjete dhe 6 (gjashtë) trupa.
 3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat e para, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, që do të hyjnë, përkatësisht, në datat 20 e 28 tetor 2009, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes porti i Durrësit.
 4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonat e dyta, të përmendura në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, që do të hyjnë, përkatësisht, në datat 20 e 28 tetor 2009, është porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.
 5. Autokolonat ushtarake slovene, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
 6. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1067, datë 21.10.2009

**PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR HAPJEN E INSTITUCIONIT ARSIMOR PRIVAT,
PARAUNIVERSITAR, SHKOLLËS 9-VJEÇARE, TË CIKLIT TË LARTË “HAFIZ
ABDULLA ZËMBLAKU”, QË NË PROGRAMIN MËSIMOR DO TË ZHVILLOJË EDHE
LËNDË FETARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e licencës për hapjen e institucionit arsimor privat, parauniversitar, shkollë 9-vjeçare, e ciklit të lartë “Hafiz Abdulla Zëmbaku”, në qytetin e Korçës, që në programin mësimor do të zhvillojë edhe lëndë fetare.
 2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore, për arsimimin, edukimin dhe formimin në këtë institucion.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1068, datë 21.10.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE “MASTER I NIVELI TË DYTË”, NË
KIMI DHE KIMI INDUSTRIALE E MJEDISORE, NË FAKULTETIN E SHKENCAVE
NATYRORE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.4, e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë “Master i nivelit të dytë”, në:
 - a) ”Kimi”, me profil “Elektrokimia e korrozionit dhe dukuritë sipërfaqësore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë”, MND, në kimi, me drejtim “Elektrokimia e korrozionit dhe dukuritë sipërfaqësore”;
 - b) ”Kimi industriale e mjedisore”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Master i nivelit të dytë”, MND, në kimi industriale e mjedisore.
2. Programet e studimit “Master i nivelit të dytë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale është një vit.
3. Këto programe studimi ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2009-2010.
4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Universitetit të Tiranës.
5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

7217

VENDIM
Nr.1069, datë 21.10.2009

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA DHE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE NATYRORE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTO PROGRAME STUDIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1,34,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Shkenca gjuhësore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në shkenca gjuhësore”;

b) Doktoratë në “Letërsi botërore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në letërsi botërore”.

2. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Fizikë”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në fizikë”;

b) Doktoratë në “Analiza kimike e lëndës dhe mjedisit”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në analiza kimike e lëndës dhe mjedisit”.

c) Doktoratë në “Elektrokimi e zbatuar dhe dukuritë sipërfaqësore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në elektrokimi të zbatuar dhe dukuritë sipërfaqësore”.

ç) Doktoratë në “Teknologjia dhe mikrobiologjia e ushqimeve & vlerësimi i sigurisë dhe cilësisë”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në teknologjia dhe mikrobiologjia e ushqimeve & vlerësimi i sigurisë dhe cilësisë”.

d) Doktoratë në “Proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe të mbeturinave industriale dhe urbane”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe të mbeturinave industriale dhe urbane”.

dh) Doktoratë në “Biologji molekulare”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në biologji molekulare”.

e) Doktoratë në “Biologji e ruajtjes”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në biologji e ruajtjes”.

ë) Doktoratë në “Bioteknologji bimore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në bioteknologji bimore”.

3. Kohëzgjatja e programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin 2009, është 137 dhe ndahet sipas fakulteteve e programeve të studimit, si më poshtë vijon:

A.Fakulteti i Gjuhëve të Huaja:

a) Doktoratë në “Shkenca gjuhësore”	25 kuota;
b) Doktoratë në “Letërsi botërore”	40 kuota;
B. Fakulteti i Shkencave Natyrore:	
a) Doktoratë në “Fizikë”	10 kuota;
b) Doktoratë në “Analiza kimike e lëndës dhe mjedisit”	10 kuota;
c) Doktoratë në “Elektrokimi e zbatuar dhe dukuritë sipërfaqësore”	10 kuota;
ç) Doktoratë në “Teknologji dhe mikrobiologjia e ushqimeve & vlerësimi i sigurisë dhe cilësisë”	6 kuota;
d) Doktoratë në “Proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe të mbeturinave industriale dhe urbane”	10 kuota;
dh) Doktoratë në “Biologji molekulare”	10 kuota;
e) Doktoratë në “Biologji e ruajtjes”	10 kuota;
ë) Doktoratë në “Bioteknologji bimore”	6 kuota.

5. Për çdo program studimi, 10% (dhjetë për qind) e kuotave të mësipërme caktohet për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve përkatëse zyrtare të këtyre trojeve.

6. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga fakulteti përkatës.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Universitetit të Tiranës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1070, datë 21.10.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFAVE TË SHKOLLIMIT
NË PROGRAMET E STUDIMEVE “MASTER I NIVELIT TË DYTË”,
NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK
2009-2010, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.829, DATË 29.7.2009 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE
“MASTER I NIVELIT TË DYTË” NË FAKULTETIN E MUZIKËS TË AKADEMISË SË
ARTEVE DHE MIRATIMIN E KUOTAVE DHE TË TARIFAVE PËR KËTO PROGRAME”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 34 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuota e pranimit në programet e studimeve “Master i nivelit të dytë” (MND), për vitin akademik 2009-2010, është 1 615, dhe ndahet, si më poshtë vijon:

a) 1 565 kuota për kandidatët shqiptarë, nga të cilat 10% në kuotën e çdo programi studimi janë për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

b) 50 kuota për studentët e huaj.

2. Kuotat e pranimit, të përcaktuara në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen në institucionet publike të arsimit të lartë dhe programet përkatëse të studimit, sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kuotat për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve përkatëse zyrtare të këtyre trojeve.

4. Kuotat e pranimit të shtetasve të huaj, në programet e studimit MND, në institucionet publike të arsimit të lartë, të Republikës së Shqipërisë, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të marrëveshjeve me vendet përkatëse dhe të kërkesave të vetë kandidatëve.

5. Tarifa e shkollimit, për studentët e regjistruar në MND, në vitin akademik 2009-2010, është 100 000 (njëqind mijë) lekë.

6. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife shkollimi, që likuidohet në këste të caktuara nga fakulteti përkatës.

7. Studentët nga Republika e Shqipërisë, që kanë kryer me rezultate të shkëlqyera ciklin pararendës të studimeve, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit.

8. Në pikën 3 të vendimit nr.829, datë 29.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve “Master i nivelit të dytë” në Fakultetin e Muzikës të Akademisë së Arteve dhe miratimin e kuotave dhe tarifave për këto programe”, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Kuota e pranimit në programin e studimeve “Master i nivelit të dytë”, në “Interpretim”, është 40. Dy kuota prej tyre caktohen për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.”.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet përkatëse publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Tabela nr.1

SHPËRNDARJA E KUOTËS SË PRANIMIT NË MND, SIPAS INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE PROGRAMEVE PÛRKATËSE TË STUDIMIT

A. UNIVERSITETI I TIRANËS

Nr.	Programi i studimit MND	Fakulteti	Kuota
1	Gjuhësi	Fakul.i Historisë dhe Filologjisë	100
2	Studime letrare	“	70
3	Shkencë e bibliotekave	“	70
4	Histori	“	60
5	Arkeologji	“	30
6	Trashëgimi kulturore	“	20
7	Marrëdhënie ndërkombëtare	“	90
8	Gjografi, me profilet:	“	
	a) Gjeografi fizike dhe mjedisore	“	70
	b) Gjeografi humane dhe rregullim territori	“	70
9	Shkenca gjuhësore	Fakul. i Gjuhëve të Huaja	50
10	Letërsi botërore	“	60
11	Kërkime në edukim	Fakul. i Shkencave Sociale	25
12	Kërkim psikologjik	“	20

13	Kërkim shkencor në punë sociale	“	25
14	Shkenca juridike civile	Fakul. i Drejtësisë	50
15	Shkencat penale	“	50
16	E drejta kushtetuese, e krahasuar dhe europiane	“	50
17	Financë	Fakulteti Ekonomik	60
18	Kontabilitet	“	40
19	Studime ekonomike europiane	“	40
20	Marketing	“	40
21	Administrim biznesi	“	40
22	Administrim publik	“	40
23	Matematikë teorike	Fakult. i Shkencave natyrore	30
24	Sisteme informatike të avancuara	“	10
25	Fizikë, me profilet:	“	
	a) Fizikë teorike llogaritëse	“	15
	b) Fizikë e aplikuar	“	15
	c) Biofizikë	“	15
26	Fizikë dhe kimi materiale	“	10
27	Inxhinieri e proceseve kimike	“	10
28	Teknologjitë dhe mikrobiologjitë e ushqimeve	“	10
29	Analiza kimike dhe instrumentale	“	10
30	Biologji, me profilet:	“	
	a) Biologji shtazore	“	15
	b) Biologji bimë	“	15
	c) Edukim biologjik	“	15
31	Biologji eksperimentale, me profilet:	“	
	a) Biologji qelizore	“	15
	b) Gjenetikë e popullatave	“	15
	c) Mikrobiologji	“	15
32	Kimi, me drejtim: Elektrokimia e korrozionit dhe dukuritë sipërfaqësore	“	10
33	Kimi industriale dhe mjedisore	“	10

B. UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Nr.	Programi i studimit MND	Fakulteti	Kuota
1	Automatikë dhe teknologjitë e kontrollit	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	20
2	Inxhinieri mekanike, me profilet:	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike	
	a) Sistemet e prodhimit dhe proceset teknologjike	“	20
	b) Sistemet e energjisë dhe proceset termike	“	20
	c) Sistemet e transportit dhe menaxhimi i trafikut	“	20
3	Materiale, me profilet:	“	
	a) Materiale metalike dhe alternative	“	20
	b) Materiale tekstile	“	20

C. UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS

Nr.	Programi i studimit MND	Fakulteti	Kuota
1	Teknologji mjedisi	Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit	20
2	Menaxhimi i resurseve dhe përmirësimi gjenetik i bimëve	“	20
3	Kontrolli i integruar i parazitëve në bimë	“	20
4	Hortikulturë e qëndrueshme	“	20
5	Shkencat e prodhimit shtazor	“	20
6	Ekonomi dhe agrobiznes, me profilet:	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	
	a) Menaxhim i ndërmarrjeve	“	20
	b) Ekonomi dhe politika agrare	“	20
	c) Zhvillimi rural i integruar	“	20
	d) Menaxhim financiar	“	20
7	Mjekësi veterinare, me profilet:	Fakulteti i Mjekësisë Veterinare	
	a) Diagnozë laboratorike	“	15
	b) Klinikë veteriniare	“	15

D. QENDRA NDËRUNIVERSITARE E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE

Nr.	Programi i studimit të MND-së	Kuota
1	Gjuhë shqipe	15
2	Studime letrare	15
3	Etnologji dhe folklor	15
4	Histori moderne e Shqipërisë	15
5	Arkeologji e prehistorisë	15
6	Arkeologji e antikitetit	15
7	Arkeologji mesjetare	15

VENDIM

Nr.1071, datë 21.10.2009

PËR LEJIMIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE, TË KRYEJË PROCEDURËN E PROKURIMIT, ME OBJEKT “BLERJEN DHE INSTALIMIN E 26 KABINAVE TË KONTROLLIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 9 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave të kryejë, brenda datës 30 nëntor 2009, procedurën e prokurimit, me objekt “Blerjen dhe instalimin e 26 kabinave të kontrollit”. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratës përkatëse.

2. Fondi limit, prej 18 120 000 (tetëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1075, datë 21.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS FARKË TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2,3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Farkë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Farkë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.123, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Farkë të qarkut të Tiranës.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Farkë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9, 480	Monumente historike, buste me interes vendor&prona social-kulturore e sportive, zhvillim turizmi	Në pronësi
10-14	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të shëndetit publik	Në pronësi
15-50	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit	Në pronësi
51-63 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe ujitjes	Në pronësi
64-67,69-72,74-76,78-80,82-85,87-94	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore)	Në përdorim
68,73,77, 81,86	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë jobujqësore)	Në përdorim
95-452,471-479	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
470	Shërbime funerale	Në pronësi

VENDIM**Nr.1076, datë 21.10.2009**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS QENDËR TEPELENË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Tepelenë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Tepelenë, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.69, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Tepelenë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Tepelenë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
400-402	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
403	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
404	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
405-605	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
606-617	Varrezat publike	Në pronësi
618-624	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
675	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
744-775,777-798,800-815,817-832,834-864,866-890,904-925,927-967,969-1019,1021-1034,1036-1049	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi
1050-1051,1054-1055,1058-1059,1063-1064,1068-1069,1073-1074,1078,1081-1082,1086-1087,1090-1091,1095-1096,1101-1102,1105-1106	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
1052-1053,1056-1057,1060-1062,1065-1067,1070-1072,1075-1077,1079-1080,1083-1085,1088-1089,1092-1094,1097-1100,1103-1104,1107-1108,632,649,651,653,657,660,663,667,669,672,674	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi

VENDIM**Nr.1079, datë 21.10.2009**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS BUZ TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2,3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Buz të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprase, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Buz të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.27, datë 14.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Buz të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Buz për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Buz

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
194-201	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
202	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
203-207	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
208-484	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
485-557	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
558-559	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
560-585	Varrezat publike	Në pronësi
586-615	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
616-626,628,632,635,639,643,645,648,653 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi

VENDIM
Nr.2/1, datë 2.10.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbërë nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Ardian Dvorani	Anëtar
Gani Dizdari	“
Evjeni Sinoimeri	“
Spiro Spiro	“
Besnik Imeraj	“
Irma Bala	“
Fatos Lulo	“
Ardian Nuni	“
Arjana Fullani	“
Evelina Qirjako	“
Majlinda Andrea	“
Guxim Zenelaj	“
Aleksandër Muskaj	“
Andi Çeliku	“

në dhomën e këshillimit të datës 02.10.2009, morën në shqyrtim çështjen penale, që i përket të gjykuarve Leonard Zeka, Nderim Deliu dhe Petrit Deliu.

OBJEKTI: *Ndreqja e vendimit nr.02, datë 06.02.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

Baza Ligjore: *Nenet 385 pika 1 e Kodit të Procedurës Penale*

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.2, datë 06.02.2009 kanë vendosur:

- Prishjen e pjesshme të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për të pandehurit Petrit Deliu e Leonard Zeka, në lidhje me cilësimin juridik të veprave penale dhe masat e dënimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2, datë 13.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për këta të gjykuar, si më poshtë:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të “rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/a e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të “vjedhjes” në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 134 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burg.

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 3 (tre) vjet burg.

Në bazë të nenit 56/1 e 55/1 të Kodit Penal, bashkimin e dënimit më sipër me dënimin prej 7 (shtatë) vjet burg të dhënë me vendimin nr.75, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Berat e të mbetur në fuqi me vendimin nr.275, datë 15.11.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit Leonard Zeka me 9 (nëntë) vjet burg, duke filluar vuajtja e dënimit nga dita e ndalimit datë 26.10.2000.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu, për veprën penale të “rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/a e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu, për veprën penale të “vjedhjes” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burg.

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 3 (tre) vjet burg, duke i filluar vuajtja e dënimit nga dita e ndalimit datë 26.10.2000.

Lënien në fuqi të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për të gjykuarin Nderim Deliu.

Ky vendim është unifikues dhe është dërguar për botim në Fletoren Zyrtare.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

VËREJNË:

Se, në dispozitivin e vendimit nr.2, datë 06.02.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, është konstatuar ekzistenca e dy gabimeve materiale, ndaj në zbatim të kërkesave të nenit 385/1 të Kodit të Procedurës Penale, kryesisht procedojnë për ndreqjen e këtij vendimi (dispozitivi), duke i korrigjuar këto gabime materiale.

Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se të dy gabimet materiale gjenden në dispozitivin e vendimit të sipërpërmendur nr.2, datë 6.02.2009 dhe pikërisht në pjesën ;

...- Prishjen e pjesshme të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për të pandehurit Petrit Deliu e Leonard Zeka, në lidhje me cilësimin juridik të veprave penale dhe masat e dënimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2, datë 13.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për këta të gjykuar, si më poshtë:...

Në këtë paragraf gabimi material konsiston në faktin se në pjesën ku thuhet ... lënien në fuqi të vendimit nr.2, datë 13.01.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në vend të këtij vendimi duhet të vendoset vendimi **nr.11, datë 25.01.2005** i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, pasi për këtë vendim bëhet fjalë që është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe këtë vendim kanë pasur parasysh dhe Kolegjet e Bashkuara në dhënien e vendimit.

Ndërsa në paragrafin tjetër ku thuhet:

...- Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 3 (tre) vjet burg, duke i filluar vuajtja e dënimit nga dita e ndalimit datë 26.10.2000.

Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se në këtë pjesë të dispozitivit të vendimit në vend të emrit të të pandehurit Leonard Zeka që është vënë gabimisht, duhet të vendoset emri i të pandehurit **Petrit Deliu**.

Bazuar sa më sipër, dhe mbështetur në nenin 385/1 të Kodit Procedurës Penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë bëjnë ndreqjen e këtyre gabimeve materiale, duke bërë dy korrigjimet e sipërpërmendura në dispozitivin e vendimit nr.2, datë 6.02.2009, të këtyre Kolegjeve.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 385 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

Ndreqjen e vendimit nr.2, datë 6.02.2009 si vijon:

- Prishjen e pjesshme të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për të pandehurit Petrit Deliu e Leonard Zeka, në lidhje me cilësimin juridik të veprave penale dhe masat e dënimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr.11, datë 25.01.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për këta të gjykuar, si më poshtë:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të “rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/a e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Leonard Zeka për veprën penale të “vjedhjes” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burg.

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Leonard Zeka me 3 (tre) vjet burg.

Në bazë të nenit 56/1 e 55/1 të Kodit Penal, bashkimin e dënimit me sipër me dënimin prej 7 (shtatë) vjet burg të dhënë me vendimin nr.75, datë 17.07.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat e të mbetur në fuqi me vendimin nr.275, datë 15.11.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dënimin përfundimisht të të pandehurit Leonard Zeka me 9 (nëntë) vjet burg, duke filluar vuajtja e dënimit nga dita e ndalimit datë 26.10.2000.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu, për veprën penale të “rrethimit ose mbajtjes peng të personit në rrethana lehtësuese” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/a e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 (tre) vjet burg.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Petrit Deliu, për veprën penale të “vjedhjes” në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134 e 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 1 (një) vit burg.

Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, dënimin e të pandehurit Petrit Deliu me 3 (tre) vjet burg, duke i filluar vuajtja e dënimit nga dita e ndalimit datë 26.10.2000.

Lënien në fuqi të vendimit nr.108, datë 24.03.2006 të Gjykatës së Apelit Vlorë, për të gjykuarin Nderim Deliu.

Anëtarë: Gani Dizdari, Ardian Dvorani, Shpresa Beçaj (kryesuese), Evjeni Sinoimeri, Spiro Spiro, Irma Bala, Andi Çeliku, Fato Lulo, Besnik Imeraj, Aleksandër Muskaj, Arjana Fullani, Ardian Nuni, Majlinda Andrea, Evelina Qirjako, Guxim Zenelaj.

VENDIM

Nr.78, datë 23.10.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MALIDO ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 dhe neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.10.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Malido Energji” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionin teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Mosplotësimin e lejes për pikën e lidhjes me sistemin elektroenergjetik (neni 9, pika 4.1.5, pika “a”), pasi aplikuesi është në proces negocimi me OSSH sh.a dhe DPR-në për t’u lidhur në rrjetin 20 kV në N/st, i cili furnizon me energji elektrike tunelin e Kalimashit.

Për gjithë sa më sipër cituar:

VENDOSI:

1. Miratimin e licencimit të shoqërisë “Malido Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Klos”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.79, datë 23.10.2009

**PËR MIRATIMIN E MODIFIKIMIT TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË SHOQËRISË BALKAN GREEN ENERGY SHPK ME SERI PV03K, NR.3,
LËSHUAR ME VENDIM TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.20, DATË
19.12.2003**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.10.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “Balkan Green Energy” sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.3, seria PVO3K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Dhe konstatoi se:

- Me vendimin nr.58, datë 7.8.2009 është miratuar fillimi i procedurave për modifikimin e licencës me numër nr.3, seri PV03K, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, të mbajtur nga shoqëria Balkan Green Energy sh.p.k.

- Është paraqitur i plotë dokumentacioni siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si dhe është plotësuar afati 2-mujor për këtë procedurë.

Për gjithë sa më sipër cituar:

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin e licencës me numër nr.3, seri PV03K, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, të mbajtur nga shoqëria Balkan Green Energy sh.p.k., duke ndryshuar aneksin “A” si në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Impianti	Nr.Njësive	Fuqia e instaluar
		lekë
HEC Arras	2	4800
HEC Funares	3	1920
HEC Dukagjin	2	640
HEC Nikolice	2	700
HEC Bulqizë	1	600
HEC Lurë	1	750
HEC Orgjost	2	1200
HEC Lekbibaj	2	1400
HEC Velçan	1	1200
HEC Zërqan	2	625
HEC Borsh	1	250
HEC Leshnicë	2	375
HEC Shoshan	2	3000
HEC Ujanik	1	630
HEC Kerpice	2	350
HEC Barmash	1	630
HEC Voskopojë	1	400
HEC Lunik	1	200
HEC Piqeras	1	200
HEC Homesh	2	395
HEC Muhur	1	250
HEC Rajan	2	620
HEC Marjan	2	420
HEC Lozhan	2	350
HEC Treskë 2	1	250

KËRKESË
Nr.6191, datë 7.10.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor bulevardi “Bajram Curri” deri në rrugën “Ali Demi”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët, që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit tokë truall.

Pronarët, për të cilët, në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Bashkisë së Tiranës (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 167 668 810 (Njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e dhjetë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

BASHKIA E TIRANËS
DREJTORIA E KONTROLLIT TË ZHVILLIMIT URBANISTIK
BULEVARDI “BAJRAM CURRI” RRUGA “ALI DEMI”
LISTA E PRONARËVE, VLERA NË LEKË DHE SIPËRFAQJA QË PREKET, SIPAS DOKUMENTEVE TË DORËZUARA

Nr.	Emër, mbiemër	Z.Kadas.	Nr.Pas	Truall	Çmimi	Objekt	Çmimi	Vlefte	Lloji i pasurisë
1	Fatime Keta + 6 bashkëpronarë	8150	8/509	1417 m ²	29.829			42,267,693	Çertifikatë pronësie
2	Fejzi Kyçyku + 8 bashkëpronarë	8150	8/64	139 m ²	29.829			4,146,231	Çertifikatë pronësie
3	Shefqet Pengili + 11 bashkëpronarë	8150	8/269	140 m ²	29.829			4,176,060	Çertifikatë pronësie
4	Njazi Çuadari + 1 bashkëpronar	8150	8/614	237 m ²	29.829			7,069,473	Çertifikatë pronësie
5	Bashkim Mema + 4 bashkëpronarë	8150	8/644	238 m ²	29.829			7,099,302	Çertifikatë pronësie
6	Hajrie Selita + 4 bashkëpronarë	8150	8/630	390 m ²	29.829			11,633,310	Çertifikatë pronësie
7	Lefteri Rudha + 3 bashkëpronarë	8150	8/628	65 m ²	29.829			1,938,885	Çertifikatë pronësie
8	Serveta Keta	8150	8/523	52.5 m ²	29.829			1,566,023	Çertifikatë pronësie
9	Besnik Keta	8150	8/524	52.5 m ²	29.829			1,566,023	Çertifikatë pronësie
10	Merita Keta	8150	8/525	20 m ²	29.829			596,580	Çertifikatë pronësie
11	Romina Keta	8150	8/526	2 m ²	29.829			59.658	Çertifikatë pronësie
12	Vladimir Luçi	8150	8/450	72 m ²	29.829			2,147,688	Çertifikatë pronësie
13	Arjan Hyka + 3 bashkëpronarë	8150	8/542	317 m ²	29.829			9,455,793	Vërtetim pronësie
14	Bajram Çeliku + 10 bashkëpronarë	8150	8/449	2479 m ²	29.829			73,946,091	Vërtetim pronësie
	TOTALI			5621 m²				167,668,810	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 25.11.2009
Doli nga shtypi më 27.11.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë